

VENDIM
Nr. 775, datë 2.11.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT 2016,
PËR KISHËN KATOLIKE NË SHQIPËRI, ME RASTIN E LUMTURIMIT TË
MARTIRËVE SHQIPTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare tradicionale, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në programin “Mbështetje për kultet fetare”, i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për financimin e Kishës Katolike në Shqipëri, me rastin e Lumturimit të Martirëve Shqiptarë.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.
 3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi